



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

STATUTI
I
POLIKLINIKËS STOMATOLOGJIKE

Prishtinë, 2023

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d, të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/2008), nenit 19, paragrafi 1, nenit 20, paragrafi 3, të Ligjit nr.04/L-125 për Shëndetësi, si dhe nenit 7 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2.1. të Ligjit Nr. 06/L-012 për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës, Prishtinën, Kuvendi i Kryeqytetit në mbledhjen e mbajtur me datë 27.06.2023 miraton:

STATUTI

I POLIKLINIKËS STOMATOLOGJIKE

NË PRISHTINË

I. Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

1.1. Me këtë Statut rregullohen: emërtimi, selia, veprimtaria, vula, statuti juridik, përfaqësimi dhe prezantimi, struktura e Poliklinikës Stomatologjike, trupat dhe fushëveprimi i tyre, organizimi sindikal, Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional, mbikëqyrja e punës, aktet e përgjithshme, pronësia, financimi dhe buxheti, transparenca në punë, fshehtësia profesionale dhe afariste, dispozita kalimtare dhe përfundimtare lidhur me ushtrimin e veprimtarisë - kujdesit dytësor në poliklinikën stomatologjike.

1.2. Kuvendi i Komunës së Prishtinës është themelues i Poliklinikës Stomatologjike.

Neni 2

Poliklinika Stomatologjike ka statusin e personit juridik, me cilësitë e autoritetit punëdhënës, ku organizohet, ofrohet dhe zbatohet kujdesi sekondar shëndetësor stomatologjik.

Neni 3

3.1. Poliklinika Stomatologjike ka në dispozicion mjetet dhe pasurinë, të cilat i përkasin Komunës së Prishtinës.

3.2 Poliklinika Stomatologjike është përvetësuese e fondit për financim nga Buxheti i Kosovës, si institucion i kujdesit shëndetësor dytësor.

II. Emërtimi dhe selia

Neni 4

4.1. Poliklinika Stomatologjike e Prishtinës është institucion publik që kryen veprimtari shëndetësore.

4.2. Emri i institucionit është Poliklinika Stomatologjike në Prishtinë.

4.3.Emërtimi i Poliklinikës Stomatologjike duhet të jetë i shkruar në gjuhët zyrtare që përdoren në Kosovë (në pllakë), i cili është i vendosur në hyrje të objektit ku kryhet veprimtaria dytësore shëndetësore.

Neni 5

5.1. Selia e Poliklinikës Stomatologjike është në Prishtinë, rr. "Enver Zymberi" nr.12.

5.2.Kuvendi i Komunës-themeluesi vendos për ndryshimin e emërtimit dhe selisë.

Neni 6

6.1. P.S. ka vulën e saj, që në qarkullim juridik paraqitet si Poliklinika Stomatologjike në Prishtinë.

6.2. Vula e rumbullakët është me diametër 2.5.cm dhe ka këtë përmbajtje:

- Rrethi i parë: Republika e Kosovës;
- Rrethi i dytë: Komuna e Prishtinës;
- Rrethi i tretë: Poliklinika Stomatologjike Prishtinë;
- Njësia Specialistike Stomatologjike;
- Në mes të vulës është emblema-gjarpri i mbështjellur në shtyllë.

6.3.Vula katrore e pranimit dhe dorëzimit është e madhësisë 7x25cm me këtë përmbajtje:

- Republika e Kosovës;
- Komuna e Prishtinës;
- Poliklinika Stomatologjike, Prishtinë;
- Njësia organizative, numri dhe data.

6.4. Me vendim të drejtorit përcaktohet numri i vulave, mënyra e përdorimit dhe autorizimi i personit për përdorim dhe ruajtje të tyre.

III. Veprimtaria e Poliklinikës Stomatologjike

Neni 7

7.1 Poliklinika Stomatologjike kryen veprimtari shëndetësore në pajtim me Ligjin për Shëndetësi, ofron shërbime specialistike stomatologjike për qytetarët e Komunës së Prishtinës nga:

- Njësia e triazhimit;
- Kirurgjia orale;
- Ortodoncia;
- Protetika stomatologjike;

- Endodoncia me stomatologji restaurative;
- Mjekësia orale me parodontologji,
- Pedodoncia dhe
- Rtg diagnostika.

7.2. Rregullon sistemin shëndetësor stomatologjik duke përbushur hapësirën ekzistuese në mes sistemit primar dhe terciar.

7.3. Në kuadër të veprimtarisë specialistike konziliare, merret me punë hulumtuese shkencore dhe Edukim të Vazhdueshëm Profesional të punëtorëve shëndetësorë.

7.4. Poliklinika Stomatologjike në bashkëpunim me QKSUK monitoron shkollimin specialistik krahas programit specialistik dhe marrëveshjes me SHSKUK-në krahas rregullativave ligjore.

Neni 8

8.1. Poliklinika Stomatologjike mund të ndryshojë apo zgjerojë veprimtarinë e vet konform Ligjit për Shëndetësi.

8.2. Kujdesi shëndetësor në Poliklinikën stomatologjike sigurohet dhe zbatohet nga profesionistët shëndetësorë, të cilët i plotësojnë kriteret e parapara me Ligjin për Shëndetësi dhe Ligjin e Punës, në përbërje nga:

- a) specialistë të kirurgjisë orale;
- b) specialistë të protetikës stomatologjike;
- c) specialistë të ortopedisë së nofullave;
- d) specialistë të parodontologjisë dhe mjekësisë orale;
- e) specialistë të endodoncisë;
- f) specialistë të pedodoncisë;
- g) asistentë të stomatologut;
- h) teknikë dentarë, dhe
- i) teknikë të rëntgenit.

IV. Statusi juridik, përfaqësimi dhe prezantimi i Poliklinikës stomatologjike

Neni 9

9.1. Poliklinika Stomatologjike është person juridik publik dhe në mënyrë të pavarur kryen veprimtarinë e saj për të cilën është themeluar, në pajtim me Ligjin për Shëndetësi, konform këtij Statuti dhe rregulloreve të tjera, akteve të përgjithshme dhe rregullave profesionale.

9.2. Poliklinika Stomatologjike ofron shërbime shëndetësore sekondare-specialistike për qytetarët e Komunës së Prishtinës sipas parimit të kujdesit shëndetësor, të përcaktuar me dispozitat e këtij Statuti, konform Ligjit për Shëndetësi dhe dispozitave tjera ligjore.

9.3. Poliklinika Stomatologjike në Prishtinë në aspektin ligjor mund të përfitojë dhe të marrë obligime, mund të jetë pronare e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, mund të jetë palë në procedura gjyqësore, organe tjera shtetërore dhe trupave me autorizime publike konform ligjit dhe këtij statuti.

9.4. Poliklinika Stomatologjike, pa pëlqimin e themeluesit nuk mund:

- të bëjë ndryshime të statutit;
- të ndryshojë ose zgjerojë veprimtarinë;
- të ndryshojë emërtimin dhe selinë;
- të themelojë tjetër person juridik;
- të garantojë për kredi.

9.5. Poliklinika Stomatologjike, pa pëlqimin e themeluesit nuk mund:

- të sjellë vendime mbi drejtimin, përdorimin dhe shfrytëzimin e patundshmërive;
- të përfitojë, të ngarkojë, tjetërsojë apo shfrytëzojë patundshmëritë;
- të vendosë mbi disponimin e fitimit dhe mbulimin e humbjeve;
- të vendosë për ndryshimin e bankës afariste, gjegjësisht mbi bartjen e mjeteve në bankë tjetër afariste;
- të vendosë për borxhin;
- të vendosë për kushtet dhe mënyrën e investimit të mjeteve të personave fizikë dhe juridikë nga vendi dhe jashtë vendit.

Neni 10

10.1. Poliklinika Stomatologjike përgjigjet me pronën e tërësishme për detyrimet e marra në procedurat juridike.

10.2. Themeluesi i Poliklinikës Stomatologjike në mënyrë solidare dhe të pakufishme përgjigjet për detyrimet e saj.

10.3. Qarkullimi i mjeteve financiare bëhet përmes një llogarie bankare-komunale.

Neni 11

Drejtori e përfaqëson, prezanton dhe e udhëheq Poliklinikën Stomatologjike dhe është përgjegjës për ligjshmërinë dhe ecurinë e punës.

Neni 12

Drejtori ka të gjitha kompetencat për përfaqësim në procedura juridike në kuadër të veprimtarive të regjistruara në regjistrin gjyqësor dhe konform këtij statuti.

Neni 13

Drejtori nuk mund të jetë palë e dytë e marrëveshjeve dhe të lidhë marrëveshje me Poliklinikën Stomatologjike në emër të vet dhe për llogari të veten dhe për llogari të personave të tjerë, ose në emër dhe llogari të personave të tjerë pa autorizimin e posaçëm të Këshillit drejtues.

Neni 14

14.1. Drejtori mund t'i bart autorizimet e tij për përfaqësim tek personat tjerë.

14.2. Drejtori lëshon autorizim me shkrim për bartjen e autorizimeve për përfaqësim në procedura juridike.

14.3. Autorizimi mund të jepet vetëm në kufinj të kompetencave të veta.

14.4. Në autorizim ceken punët dhe veprimtaritë për të cilat është dhënë autorizimi.

Neni 15

Drejtori i Poliklinikës Stomatologjike përcakton punëtorët e autorizuar, për nënshkrimin e dokumenteve financiare dhe të tjera.

V. Organizimi i Poliklinikës stomatologjike

Neni 16

16.1. Në Poliklinikën Stomatologjike janë të organizuara këto njësi, me qëllim të kryerjes së veprimtarisë stomatologjike:

- njësia e triazhimit;
- njësia e protetikës stomatologjike;
- njësia e ortopedisë së nofullave;
- njësia e kirurgjisë orale;
- njësia e endodoncisë;
- njësia e mjekësisë orale dhe paradontologjisë;
- njësia e pedodoncisë;

- njësia e teknikës dentare;
- rtg diagnostika, dhe
- depo dentare.

16.2. Në Poliklinikën stomatologjike janë të organizuara këto njësi, me qëllim të kryerjes së punëve profesionale dhe administrative:

- shërbimi financiar- kontabiliteti;
- shërbimi juridik;
- shërbimi i burimeve njerëzore (mirëmbajtja e dosjeve, licencat, evidentimi i pushimeve etj.);
- shërbimi teknik.

16.3. Organizimi i brendshëm i Poliklinikës Stomatologjike përcaktohet me Rregulloren për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës.

Neni 17

Vendet e punës që i nënshtrohen rizgjedhjes në Poliklinikën Stomatologjike janë: drejtori, drejtori shëndetësor dhe kryeinfermieri.

Punëtorët që i nënshtrohen rizgjedhjes, emërohen në mandat në kohëzgjatje prej 3 vitesh me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat të dytë.

VI. Trupat dhe fushëveprimi i tyre

Këshilli drejtues

Neni 18

18.1. Këshilli Drejtues drejton aktivitetet e Poliklinikës Stomatologjike, nën udhëheqjen e drejtorit, ndërkaq ky këshill përbëhet nga shtatë (7) anëtar:

- drejtori si udhëheqës i Këshillit Drejtues;
- drejtori shëndetësor,
- zyrtari ligjor,
- zyrtari i financave,
- koordinatori për cilësi dhe siguri,
- kryeinfermieri,
- përfaqësuesi nga Këshilli i pacientëve,
- përfaqësuesi nga Këshilli i sindikatës (në cilësinë e vëzhguesit).

18.2. Mandati i anëtarëve të Këshillit Drejtues zgjat tre (3) vite, por mund të përfundojë edhe me parë në rastet kur:

- anëtari ndërpre në marrëdhënien e punës në PS;
- anëtari i Këshillit drejtues jep dorëheqje;
- anëtari i Këshillit drejtues mungon pa arsye në mbledhje të këshillit, brenda vitit, tre herë radhazi;
- anëtari nuk respekton detyrat e punës.

Neni 19

19.1. Këshilli Drejtues do të jetë përgjegjës për:

- veprimtarinë e PS-së dhe vërtetimin e politikës së punës së PS-së;
- propozimin e ndryshimeve të Statutit të PS-së;
- miratimin e raportit të punës dhe llogaritë vjetore të PS-së;
- shfrytëzimin e mjeteve në kuadër të ligjit;

- nxjerrjen e programit të punës dhe planit financiar;
- miratimin e Rregullores për organizimin e punës në PS dhe akte të tjera në përputhje me ligjin dhe statutin;
- hartimin e planit të burimeve njerëzore sipas propozimit të Këshillit drejtues, brenda resurseve në dispozicion dhe në përputhje me nevojat e shërbimit;
- propozon themeluesit miratimin e çmimeve që i ofron PS për shërbimet shëndetësore, të cilat nuk janë të përcaktuara nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë;
- hartimin e planit për furnizim të PS-së;
- hartimin e planit dhe programit të masave për mbrojtje në punë dhe mbarëvajtjen e punëve;
- emërimin e komisioneve të përkohshme dhe të organeve tjera punuese;
- sigurimin e pasurisë së PS-së, sigurimin e punëtorëve në bazë të ligjit;
- shqyrtimin e njoftimeve për mbikëqyrjen e raporteve të përkohshme mbi punën profesionale;
- punë të tjera, të cilat i janë lënë në kompetencë me këtë statut dhe akte të tjera normative të PS-së.

19.2. Përbërja dhe organizimi i Këshillit Drejtues do të rregullohet me rregullore të veçantë.

Neni 20

- Drejtoria e poliklinikës përbëhet nga:
 - drejtori
 - drejtori shëndetësor,
 - kryeinfermieri,
 - shërbimi administrativ.

Neni 21 Drejtori

21.1. Drejtori i Poliklinikës Stomatologjike udhëheq Poliklinikën Stomatologjike.

21.2. Drejtori organizon, udhëheq dhe përfaqëson poliklinikën. Është përgjegjës për ligjshmërinë e punës së poliklinikës.

21.3. Kryetari i komunës cakton drejtorin e PS-së, pas shpalljes së konkursit publik, propozimit të komisionit intervistues dhe mendimit të drejtorit të DSH-së, në pajtim me dispozitat që rregullojnë marrëdhënien e punës të institucionet publike.

21.4. Drejtor i poliklinikës mund të emërohet personi që i plotëson këto kushte:

- të ketë të përfunduar studimet universitare dhe të ketë ngritje të lartë profesionale, specialist në ndonjërin nga fushat e stomatologjisë sekondare;

- të ketë pesë (5) vite përvojë pune në profesion, me shkathtësi menaxheriale (së paku tri vjet përvojë pune në pozita menaxheriale në sistemin shëndetësor)

Neni 22 Drejtori shëndetësor;

22.1 –Drejtori shëndetësor zgjedhet me konkurs të brendshëm .

- mandati zgjat 3 vjet, me mundësi rizgjedhje edhe për një mandat tjetër

Drejtori shëndetësor duhet ti plotësoj kriteret ne vijim:

- të ketë të përfunduar studimet universitare dhe të ketë ngritje të lartë profesionale, specialist në ndonjërin nga fushat e stomatologjisë sekondare; të ketë pesë (5) vite përvojë pune në profesion, me shkathtësi menaxheriale

22.2- Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit shëndetësor:

- drejtori shëndetësor planifikon, organizon dhe mbikëqyrë zbatimin e punës profesionale
- e mbështet drejtorin e Poliklinikës në realizimin e programit të punës
- siguron udhëheqje dhe udhëzime profesionale për stafin, duke siguruar përdorimin efikas të resurseve, për të ofruar nivel sa më të lartë të kujdesit shëndetësor për pacientin
- vlerëson rezultatet e punës në kujdesin shëndetësor
- monitoron përmbushjen e standardeve të cilësisë se punës dhe mosrespektimin eventuale të tyre
- në rast të mospërmbushjes së detyrave mund të shkarkohet nga Drejtori i Poliklinikës

Neni 23

23.1. Vendimin për shpalljen e konkursit për drejtor të Poliklinikës Stomatologjike e merr Kryetari i komunës.

23.2. Kryetari i komunës autorizon drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë të shpallë konkurs për drejtor të Poliklinikës Stomatologjike.

Neni 24

24.1. Drejtori i PS-së është përgjegjës për të siguruar ligjshmërinë dhe punën profesionale të PS-së, e cila duhet të organizohet dhe të udhëhiqet konform këtij statuti dhe dispozitave ligjore.

24.2. Drejtori i PS-së është përgjegjës për përkujdesjen shëndetësore dytësore stomatologjike, për të gjithë banorët e Komunës së Prishtinës, si dhe është përgjegjës për detyrat në vijim:

- i propozon Drejtorisë së Shëndetësisë planin e punës dhe buxhetin e PS-së për vitin vijues;
- në mbikëqyrjen dhe autorizimin e drejtorit të D.SH-së, zbaton buxhetin e PS-së.

24.3. Drejtori i P.S është përgjegjës për:

- zbatimin e planit të burimeve njerëzore;
- udhëheqjen e përditshme të procesit të punës në PS;
- zhvillimin e marrëdhënieve të mira me donatorë dhe OJQ;
- zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe trajnimin e personelit të PS-së;
- dhënien e kontributit për zhvillimin e sistemit të informimit shëndetësor të PS-së, sipas standardeve të pranuar, sigurimin e mbledhjes së informatave dhe avancimin e punës ekipore.

24.4. Në programin vjetor të punës duhet të përcaktohen:

- masat, aktivitetet dhe rezultatet e pritura të kujdesit shëndetësor në PS;
- plani vjetor i punës;
- organizimi dhe udhëheqja;
- burimet njerëzore;
- plani financiar;
- raportet mujore, vjetore të punës dhe raportet financiare.

24.5 Drejtori i PS-së i përgjigjet drejtorit të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Kryetarit të Komunës për kryerjen e punëve të tij.

VII. Trupat e Poliklinikës Stomatologjike

Neni 25

25.1. Për përmbushjen e detyrave të veçanta, Këshilli drejtues, përmes drejtorit të PS-së formon trupa profesionale në PS, siç janë:

- Komisioni disiplinor i PS-së;
- Komisioni i ankesave i PS-së;
- Komiteti për cilësi dhe siguri të shërbimeve shëndetësore;
- Komiteti për edukim të vazhdueshëm profesional.

Neni 26

VIII. Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional

1. Institucioni shëndetësor (PS) është i obliguar që të mundësojë dhe përkrahë zhvillimin e vazhdueshëm profesional të punëtorëve të tyre shëndetësor.

2. Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional është i obligueshëm për të gjithë profesionistët shëndetësorë në PS, dhe zbatohet sipas plan programit, të aprovuar nga Odat e profesionistëve shëndetësorë.

3. Për zhvillimin e aktiviteteve nga paragrafi 2 i këtij neni, përgjegjës janë koordinatorët dhe trajnuesit në PS, të cilët duhet të kenë përgatitje adekuate akademike dhe profesionale dhe caktohen sipas termave të referencës të hartuar nga Ministria e Shëndetësisë.

4. Financimi i ZHVP-së për profesionistët shëndetësorë bëhet nga buxheti i PS-së dhe burimet tjera, të bazuara nga aktet tjera normative në fuqi.

IX. Organizimi sindikal

Neni 27

27.1. Në Poliklinikën stomatologjike mund të organizohen organizata sindikale, ku punëtorët me anëtarësimin e tyre vullnetar, do t'i realizojnë të drejtat dhe interesat e veta të garantuara me konventat ndërkombëtare të punës dhe sipas ligjit.

27.2. Në rast të organizimit të grevave të punëtorëve, PS duhet të sigurojë minimumin e kryerjes së detyrave të punës apo shërbimeve stomatologjike.

X. Mbikëqyrja e Poliklinikës stomatologjike

Neni 28

28.1. PS-së i nënshtrohet mbikëqyrjes ligjore dhe profesionale, e cila sigurohet përmes organeve të autorizuar në bazë të këtij statuti dhe dispozitave tjera ligjore.

28.2. Mbikëqyrjen në PS, e bën Këshilli Drejtues i institucionit, përzgjedhja e të cilit përcaktohet me udhëzime administrative të nxjerra nga ministria.

28.3. Mbikëqyrja e brendshme e punës profesionale kryhet në mënyrë të paraparë me Rregulloren mbi mbikëqyrjen e brendshme, të cilën e nxjerr Këshilli drejtues i poliklinikës stomatologjike.

XI. Aktet e përgjithshme

Neni 29

Aktet e përgjithshme të PS-së janë: statuti, rregulloret, urdhëresat dhe aktet tjera me të cilat rregullohen çështje të veçanta të veprimtarive të poliklinikës.

Neni 30

Këshilli Drejtues nxjerr këto akte të përgjithshme të PS-së me me propozim të drejtorit:

- Rregullore për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës;
- Rregullore për përgjegjësinë disiplinore të punonjësve;
- Rregullore për mbrojtje në punë;
- Rregullore për mbrojtje kundër zjarrit;
- Rregullore për rendin shtëpiak;
- Rregullore për parandalimin e infeksioneve;
- Rregullore të tjera për mbarëvajtjen e punës në PS.

XII. Pronësia, buxheti dhe financat

Pronësia Neni 31

Pasurinë e PS-së e përbëjnë të drejtat dhe të mirat materiale që janë të evidencuara si pronë komunale, të cilat PS ka të drejtë t'i ketë në dispozicion, nga data e hyrjes në fuqi të Ligjit për Shëndetësi në Kosovë.

Buxheti Neni 32

32.1. Çështjet buxhetore dhe financiare të PS-së administrohen në mënyrë transparente në pajtim me rregulloret mbi përdorimin e fondeve nga Buxheti i Kosovës, si dhe me të gjitha procedurat në përputhje me udhëzuesit e Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave.

32.2. Buxheti dhe llogaritë e Poliklinikës Stomatologjike duhet t'i përfshijnë të gjitha shpenzimet operative të njësive punuese.

32.3. Poliklinika Stomatologjike i prezanton buxhetin vjetor për miratim Drejtorisë së Shëndetësisë.

32.4. Kryetari i komunës dhe drejtori i DSH-së mund të kërkojnë revizion të jashtëm për monitorimin e shfrytëzimit të drejtë të mjeteve.

32.5 Çdo prokurim do të zhvillohet në harmoni me Ligjin e prokurimit publik.

Financimi Neni 33

33.1. Poliklinika Stomatologjike shfrytëzon burimet financiare në përputhje me Ligjin për Shëndetësi në Kosovë, nga buxheti i Kosovës dhe burimet tjera të parapara me ligjet përkatëse.

33.2. Bashkëpagesa për shërbimet e ofruara në PS, si burim i financimit të aktiviteteve të PS-së do të bëhet në bazë të çmimoreve të miratuar sipas ligjeve në fuqi.

33.3. PS mund të nxjerrë akte të veçanta të detajuara për llojin dhe shumën e pagesave të ndryshme, që do të jenë në pajtim me rregulloret përkatëse të nxjerra nga Ministria e Shëndetësisë.

XIII. Transparenca në punë

Neni 34

34.1. Puna e Poliklinikës Stomatologjike është publike.

34.2. Poliklinika Stomatologjike publikon të dhënat për kushtet dhe mënyrat e ofrimit të shërbimeve në rrjetin e stacioneve të veta.

34.3. Informatat dhe të dhënat për kryerjen e veprimtarive ose për dokumentacionin mbi veprimtaritë e Poliklinikës Stomatologjike, mjeteve të informimit mund t'i japë vetëm drejtori ose punëtori i poliklinikës i autorizuar nga ai.

XIV. Fshehtësia profesionale dhe afariste

Neni 35

35.1. Fshehtësi afariste konsiderohen dokumentet dhe të dhënat, publikimi i të cilave ose dhënia personave të paautorizuar, do të ishte kundër interesave afariste, ose do të dëmtonte imazhin afarist të poliklinikës.

35.2. Fshehtësinë afariste e kanë obligim ta ruajnë anëtarët e Këshillit Drejtues, si dhe të gjithë punëtorët që kanë njohuri për dokumente ose të dhëna që konsiderohen fshehtësi afariste.

35.3. Shkelja e obligimit të ruajtjes së fshehtësisë afariste konsiderohet shkelje e kontratës së punës.

XV. Dispozitat kalimtare dhe përmbyllëse

Neni 36

36.1. Në ditën e hyrjes në fuqi të këtij Statuti, përfundon fuqia e akteve tjera që rregullojnë punën e poliklinikës, e që janë në kundërshtim me këtë Statut.

36.2. Ky Statut hyn në fuqi me datë 03.01.2024. Para datës së hyrjes në fuqi, ky statut duhet së paku 15 ditë përpara të ketë kaluar procedurën e regjistrimit në Zyrën e Protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhët zyrtare në web-faqen e komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-110/04-134288/23, më 29.06.2023

KRYESUESI I MBLEDHJES SË KUVENDIT
AJET BRAJSHORI

